Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

---

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 20 (paragrafi 1) të Ligjit 08/L-063 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Kanë të Bëjnë ne Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 30, 5.09.2022), në përputhje me nenin 11, paragrafi1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 8 (nën paragrafi 1.4) të Rregullores QRK -NR. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022, si dhe nenin 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerrë:

RREGULLORE MD - Nr.06/2023[1]
PËR PROCEDURËN E ANKESAVE PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë rregullore themelohet Komisioni për Ankesa dhe përcaktohen procedurat për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (në tekstin e mëtejmë: Agjencia).

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për të gjithë personat që marrin pjesë në procesin e shqyrtimit të ankesave dhe nga personat që paraqesin ankesë ndaj çdo vendimi të Agjencisë.

[1] Rregullore MD - Nr.05/2023 për procedurën e ankesave për ndihmë juridike falas, i nënshkruar nga Ministrja e Drejtësisë, më datë 06.06.2023.

KAPITULLI II
KOMISIONI I ANKESAVE

Neni 3
Themelimi i Komisionit

1. Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj çdo vendimi të Agjencisë (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) themelohet me vendim të Ministrit të Drejtësisë (në tekstin e mëtejmë: Ministri) dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë, si në vijim:

1.1. Një (1) përfaqësues nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë;

1.2. Një (1) profesor nga Fakulteti Juridik;

1.3. Një (1) përfaqësues nga shoqërisë civile.

2. Përbërja e Komisionit duhet të reflektojë barazinë gjinore.

Neni 4
Mandati i Komisionit

Anëtarët e Komisionit (Kryetari dhe anëtarët) emërohen me mandat tre (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Neni 5
Kryetari i Komisionit

1. Kryetari i Komisionit ka këto kompetenca:

1.1.organizon dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës së Komisionit;

1.2. siguron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

1.3. thërret dhe kryeson takimet e Komisionit.

Neni 6
Anëtarët e Komisionit

1. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive në përputhje me mandatin e Komisionit.

2. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar të marrin pjesë në takimet e Komisionit.

Neni 7
Pavarësia

Anëtarët e Komisionit janë të pavarur në punën e tyre dhe kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 8
Takimet

1.Komisioni mbanë takime sipas rasteve të paraqitura.

2. Kryetari i Komisionit njofton me shkrim së paku tre (3) ditë më herët anëtarët e Komisionit për kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit.

3. Mbledhjet e Komisionit të ankesave janë të hapura, me përjashtim të rasteve kur me kërkesën e palës përjashtohet publiku ose kur përjashtimi i publikut parashihet me legjislacionin në fuqi.

4. Në rastin e mbledhjeve të hapura për publikun, data, ora dhe vendi i zhvillimit të mbledhjes njoftohen me mjete të përshtatshme për të mundësuar pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

Neni 9
Marrja e vendimeve të Komisionit

1.Vendimet e Komisionit merren me shumicë të votave të anëtarëve.

2. Kryetari dhe cilido anëtar i Komisionit nuk merr pjesë në shqyrtimin e ndonjë çështje për të cilën ai ka konflikt interesi në pajtim me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit.

Neni 10
Procesverbali i takimit

1. Për çdo takim të Komisionit mbahet procesverbal, i cili miratohet në takimin e radhës nga Komisioni.

2.Procesverbali mbahet nga zyrtarët e Agjencisë.

3. Në procesverbal bëhet një përmbledhje e diskutimit, data dhe vendi i takimit, anëtarët që marrin pjesë, vendimet që u morën si dhe forma dhe rezultati i votimit.

Neni 11
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vendosjen për ankesat e kërkuesve dhe përfituesve të ndihmës juridike falas, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Komisioni shqyrton lejueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesave të palëve dhe nxjerrë vendim me shkrim për çdo ankesë të shqyrtuar.

3. Komisioni gjatë shqyrtimit të ankesave, mund të kërkojë informacion dhe dokumentacion shtesë nga zyrtari përkatës në kuadër të Agjencisë që ka trajtuar lëndën në shqyrtim.

3. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe procesmbajtësi.

4. Komisioni për punën e kryer raporton tek Ministri një herë në vit.

5.Punët administrative-teknike për Komisionin i kryen Agjencia.

KAPITULLI III
PROCEDURA LIDHUR ME ANKESAT

Neni 12
E drejta për ankesë

1. Të drejtën për të parashtruar ankesë tek Komisioni e ka çdo kërkues kundër çdo vendimi mbi refuzimin e ndihmës juridike falas si dhe çdo përfitues kundër vendimit për shërbimet juridike.

2. Ankesa nga paragrafi 1 i këtij neni i paraqitet Komisionit përmes Agjencisë në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

3. Parashtruesi i ankesës mund të ushtrojë vetëm një herë ankesë tek Komisioni për të njëjtën çështje.

Neni 13
Parashtrimi i ankesës

1.Ankesa së bashku me dokumentacionin përkatës, mund të dërgohet në Agjenci në njërën nga këto mënyra:

1.1. drejtpërdrejtë;

1.2. me postë;

1.3. me postë elektronike (e-mail).

2.Pas pranimit të ankesës në Agjenci, formohet lënda e cila regjistrohet sipas datës së pranimit në regjistrin dhe merr numrin e vet.

3.Ankesa parashtrohet me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe duhet të jetë e nënshkruar nga ankuesi ose i autorizuari i tij.

4.Parashtruesi i ankesës mund të autorizojë përfaqësuesin e tij përmes autorizimit me shkrim.

5. Ankesa e parashtruar duhet të përmbajë këto të dhëna:

5.1. emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të parashtruesit të ankesës;

5.2. të dhënat për aktin administrativ të nxjerrë apo të munguar i cili kontestohet;

5.3. shkaqet e ankimimit, pretendimet dhe çdo dokumentacion tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga parashtruesi i ankesës.

6.Komisioni duhet të njoftohet nga parashtruesi i ankesës ose i autorizuari i tij, për çfarëdo ndryshimi të adresës apo numrit të telefonit të tij apo përfaqësuesit të tij.

7. Forma dhe përmbajtja e formularit të ankesës është pjesë e kësaj Rregulloreje (Shtojca 1).

8. Formulari i Ankesës publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë.

Neni 14
Seanca për shqyrtimin e ankesës

1. Komisioni në afat sa më të arsyeshëm, por jo më larg se shtatë (7) ditë nga momenti i dorëzimit të ankesës, mbanë seancën për shqyrtimin e ankesës.

2. Komisioni gjatë shqyrtimit të ankesës mund të kërkojë nga palët, dokumentacion apo informacione të nevojshme, si dhe të verifikojë situatën në teren.

Neni 15
Pjesëmarrja e palëve në seancë

1.Pjesëmarrja e palëve në procedurë, në seancat e Komisionit, bëhet vetëm në rastet kur Komisioni vlerëson se është e nevojshme ose sipas kërkesës së palëve.

2. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, Komisioni e autorizon njërin nga anëtarët e Komisionit që në bashkëpunim me administratën e Agjencisë të sigurojnë kushtet për mbajtjen e kësaj seance.

3. Ftesa për mbajtjen e seancës së shqyrtimit i dërgohet palëve së paku pesë (5) ditë para seancës dhe përmban këto të dhëna:

3.1.qëllimin, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës;

3.2.vërejtjen se Komisioni ka autoritet të procedojë pa vonesë apo njoftim të mëtejshëm, pavarësisht nga dështimi i një pale që të paraqitet në kohë dhe vend të caktuar, në rast të mungesës së paarsyeshme.

4.Pala që kërkon shtyrjen e seancës së shqyrtimit, duhet t'i paraqesë Komisionit një kërkesë të arsyetuar me shkrim jo më larg se tre (3) ditë nga momenti i pranimit të ftesës.

5. Komisioni brenda dy (2) ditëve nga momenti i pranimit të kërkesës, vendosë nëse kërkesa për shtyrjen e seancës është e bazuar dhe shënohet në procesverbal.

6. Nëse Komisioni e aprovon kërkesën e palës për shtyrje të seancës, i njofton menjëherë palët në procedurë për shtyrjen e seancës.

7. Të gjitha palët dhe pjesëmarrësit në procedurë kanë të drejtë të paraqiten në seancë personalisht, ose përmes përfaqësuesit të autorizuar.

8. Palët në procedurë janë të barabarta dhe secilës palë i jepet mundësia e prezantimit të provave dhe të dëshmive për arsyetimin e pretendimeve të tyre.

Neni 16
Vendimi i Komisionit

1. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni merr vendim me të cilin:

    1.1. hedhë ankesën si të palejuar;

    1.2. aprovon ankesën si të bazuar;

    1.3. refuzon ankesën si të pabazuar.

2.Vendimet i nxjerrë Komisioni, ndërsa i nënshkruan Kryesuesi i Komisionit.

3.Komisioni vendos për ankesën sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të ankesës.

Neni 17
Mjeti Juridik

Kundër vendimit të Komisionit, pala e pakënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën kompetente.

Neni 18
Njoftimi i palës

Vendimi i Komisionit i dërgohet palës që ka parashtruar ankesë, apo personit të autorizuar të palës.

KAPITULLI IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Shfuqizimi i legjislacionit ekzistues në fuqi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje pushojnë të vlejnë dispozitat ekzistuese për procedurat e ankesave për ndihmë juridike falas.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

_____

Ministre e Drejtësisë

___/___/2023

Shtojca nr.1: *Formular i Ankesës*

ANKESË

Unë _____, më datë _____, kam aplikuar për ndihmë juridike falas në _____, zyra në _____,

☐ kam pranuar vendim për refuzim

☐ nuk kam pranuar vendim

Prandaj, parashtroj këtë ankesë, me arsyetimin si në vijim:

_____
_____
_____
_____
_____
_____

Nëse kjo hapësirë është e pamjaftueshme, atëherë mund të përdorni faqe shtesë.

☐ Unë (gjithashtu) parashtrojë ankesë si rezultat i shërbimeve joprofesionale ose jo-etike nga

☐ Zyrtari/ja për ndihmë juridike falas _____

☐ Avokati/ja, i/e autorizuar nga Agjencia _____

☐ OJQ _____

Unë mendoj se këto shërbime ishin joprofesionale ose jo-etike, sepse:

_____
_____
_____
_____
_____
_____

Nëse kjo hapësirë është e pamjaftueshme, atëherë mund të përdorni faqe shtesë.

Nënshkrimi i parashtruesit/es të kërkesës: _____ Data: _____

Numri i telefonit: _____